



## **Mbi procedurat e pageses se demshperblimit te ish te denuarve politike**

Ne zbatim te ligjit nr 9831 date 12.11.2007 "Per demshperblimin e ish te denuarve politike te regjimit komunist", ndryshuar me ligjin nr.10111 date 2.04.2009 "Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr 9831 date 12.11.2007 "Per demshperblimin e ish te denuarve politike te regjimit komunist" dhe Vendimit te Keshillit te Ministrave nr 1699 date 29.12.2008 "Per miratimin e demshperblimit financiar per ish te denuarit politike te regjimit komunist, per vitin 2008"

### **Sqarojme;**

#### **1. Informacion te pergjithshem**

- a. Ministria e Drejtesise ne baze te ligjit te mesiperm ndjek te gjithe proceduren e informacionit per dosjet individuale deri ne nxjerjen e Vendimit te Keshillit te Ministrave dhe dergimin e tij me listat bashkangjitur ne Ministrine e Financave per pagese.
- b. Verifikimi per perfitimet e meparshme te ish te denuarve eshte informacion i derguar ne Ministrine e Drejtesise nga Ministria e Financave per shumate ne letra me vlere dhe leke perpara vitit 1997. Ky informacion eshte marre nga ish Banka e Kursimeve (sot Raiffeisen Bank) dhe per kete Ministria e Financave komunikon direkt me Ministrine e Drejtesise. Keto perfitime sipas ligjit te sipercituar i raportohen Ministrise se Drejtesise, ne mungese te tyre merren per baze deklarimet e personave.
- c. Per kete ceshtje Ministria e Financave nuk ka ne detyrim apo funksion te jape sqarime individuale pasi jo vetem eshte e qarte, por edhe eshte praktikisht e pamundur. Prandaj, komunikimi do te jete vetem shkresor.
- d. Ne rast se ish te denuarit kane verejtje per perfitimet e meparshme, gabime te mundshme, etj do te drejtojne kerkese zyrtare Ministrise Drejtesise per korigjime te mundshme nese rezultojne nje gje e tille.
- e. **Ministria e Financave ndjek procedurat e pageses vetem pasi ish i denuari eshte perfshire ne listen e VKM-se dhe nuk ka asnje kompetence apo funksion per procedurat perpara daljes se Vendimit te Keshillit te Ministrave per pagesat individuale.** Pra Ministria e Financave (Drejtoria e Pergjithshme e Thesarit) eshte ngarkuar per te ndjekur vetem pagesen sipas VKM duke depozituar direkt ne llogarite personale te ish te denuarve ose te trazhgimtarit (trazhgimtareve) kur ish i denuari nuk jeton.

#### **2. Per personat ish te denuar politike qe jetojne.**

- a. Pasi eshte siguruar i denuari politik qe emri i ka dale per pagese ne VKM duhet te ndjeke njerin nga dy opsionet e meposthme;
  - Te depozitoje prane deges se thesarit ku ato jetojne vetem numrin e llogarise ne emer te tyre ne nje nga bankat; *Alpha Bank, Raiffeisen Bank, Banka Popullore, NBG, BKT, Banka e Tiranes, Union Bank, Banka Nderkombetare e Tregtare.* Pranohet numri i llogarise vetem ne nje nga keto banka, sepse keto jane zgjedhur si kerkese e ligjit.
  - Ose te dergojne me poste kete numer llogarie ne emer te tyre ne adresen; Ministria e Financave, Drejtoria e Pergjithshme e Thesarit, Tirane.

- b. Me mberritjen e numrave te llogarise Ministria e Financave proceson pagesat nga Banka e Shqiperise ne llogarite personale te perfituesve (ish te denuarve). Eshte kusht i domosdoshem per pagese perputhja e plote; Emer, Atesi e Mbiemer ne liste me ato ne llogarine bankare.

**3. Per personat me denim kapital dhe qe trashegimtarete jane listuar ne VKM nr 1699 date 29.12.2008.**

- a. Trashegimtarete do te veprojne ne te njejten menyre duke ndjekur njerin nga dy obsionet e listuara ne piken 2 (a). Pra te gjithë trashegimtarete e te pushkatuarit depozitojne prane deges se thesarit ku jetojne ose dergojne me poste numrin e llogarise (te hapura ne nje nga bankat e permendura me lart) ne adresen; Ministria e Financave, Drejtoria e Pergjithshme e Thesarit, Tirane.
- b. Veprimet per rastet sipas pikes 3 (a) mund te kryhen edhe ne emer te nje trazhgimtari te vetem kur se bashku me numrin e llogarise depozitohet nje prokure qe trazhgimtarete e tjere autorizojne njerin prej tyre per kryerjen e veprimeve te pagesave. Pagesa pastaj vijon normalisht nga Banka e Shqiperise ne llogarine e perfituesit. Eshte kusht i domosdoshem per pagese perputhja e plote; Emer, Atesi e Mbiemer ne liste me ato ne llogarine bankare.

**4. Per personat ish te denuar te listuar ne VKM qe nuk jetojne ose kane vdekur pas daljes se Vendimit per demshperblim.**

- a. Ne keto raste meqe personi i denuar nuk jeton dhe qe sipas vendimit ka emrin ne liste per demshperblim trazhgimtarete e ligjshem do te jene perfituesit. Ne menyre qe perfituesit te terheqin pagesen duehet qe te depozitojne prane deges se thesarit ose prane Ministrise se Financave keto dokumente;
- Certificate vdekje te ish te denuarit
  - Certificate te trungut familjar
  - Deshmine e trashegimnise te ish te denuarit politik
  - Prokure kur autorizohet nje person per te bere veprimet
  - Numrin e llogarise ne njerin nga bankat e lartpermendura.
- b. Pagesa pastaj vijon normalisht nga Banka e Shqiperise ne llogarine e perfituesit brenda nje muaji. Eshte kusht i domosdoshem per pagese perputhja e plote; Emer, Atesi e Mbiemer ne liste me ato ne llogarine bankare si dhe kompletimi i praktikes me te gjithë trashegimtarete ligjore sipas nenit 8 pika 1 te ligjit nr.10111 date 2.04.2009 “Per disa shtesa dhe ndryshime te ligjit nr 9831 date 12.11.2007 “Per demshperblimin e ish te denuarve politike te regjimit komunist”.

Po behen te gjitha perpjekjet per te proceduar sa me shpejt me pagesat. Per kete se shpejti do te kete nje sektor i posacem qe do te ndjeke kete procedure kete vit dhe ne vazhdim. Ne vazhdimesi informacioni yne do te jete afishuar prane degeve te thesarit, ne website te Ministrise se Financave si dhe prane shoqatave te ish te denuarve politike.

Nga ana tjeter kerkojme bashkepunimin dhe mirekuptimin e te gjithë ish te denuarve e trazhgimtareve te tyre qe ne kete proces te kuptohet se nje proces i tille nuk mund te perfundoje ne afate mujore. **Radha** dhe **ekzaktesia** ne depozitim e dokumentacionit jane kriteret dhe njekohesht celesi per shpejtimin e ekzektuimit te pagesave.

Duke ju faleminderuar per bashkepunimin,

**DREJTORIA E PERGJITHSHME E THESARIT**